VENDIM
Nr. 91, datë 6.2.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 484, DATË 24.7.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË POZICIONEVE "KOORDINATOR KUNDËR KORRUPSIONIT" NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" e "b", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 848, datë 24.7.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 2, e vendimit nr. 484, datë 24.7.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të pozicioneve "koordinator kundër korrupsionit" në disa institucione të administratës shtetërore", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit, e përcaktuar në lidhjen nr. 2 të këtij vendimi, dhe shtesa për vjetërsi kanë të njëjtën vlerë dhe mënyrë llogaritjeje me atë të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë me arsim të lartë në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.".

2. Vlerat e elementit "paga e pozicionit", në lidhjen nr. 2 të këtij vendimi, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i institucioneve shëndetësore përkatëse, të miratuara në ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026".

4. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 2

Paga bruto mujore për pozicionet "koordinator kundër korrupsionit", në institucionet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi

Pozicioni	Paga bruto mujore		
	Grupi i diplomës	Shtesa për vjetërsi	Paga e pozicionit
Koordinator në: - Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".	1		174 250
Koordinator në:	1		164 000

- Spitalin Universitar të Traumës; - Qendrën Spitalore Rajonale, të Tiranës “Shefqet Ndroqi”.			
Koordinator në: - Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1		158 875
Koordinator në: - Spitalin Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”; - Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.	1		144 525